



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 22.03.2021 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e dytë rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Trotualet, lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese;
 - Qentë endacak;
 - Siguria në Trafik;
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për Siguri në shkolla;
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
4. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve Urbane;
5. Të Ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Kryetari – Do i japë disa informatë sa i përket situatës me Covid – 19 në Komunën e Rahovecit, pasi që drejtori i shëndetësisë nuk qenka sot prezent. Nëse ja fillojmë me ditën e sotit, ne kemi disa raste të reja me Covid – 19, poashtu kemi edhe disa raste të shëruara, nga informatat që na kanë ardhur sot zyrtare gjithsej kemi 924, aktivë janë 226, kurse të shëruar 628, kurse me vdekje kemi 60 raste. Ne si komunë vazhdojmë të jemi në zonë e gjelbër me masat që cilat vazhdojnë të jenë në fuqi. Ne në bazë ditore i bëjmë dezinfektimin e objekteve shëndetësore, kurse në baza javore bëhet dezinfektimi i objekteve arsimore, poashtu jemi duke u munduar që të jemi të kujdesshëm edhe me materiale mbrojtëse që të kenë të gjitha objektet publike. Shtabi emergjentë komunal sot ka mbajtur takimin e tij, ku ka konstatuar edhe pse jemi në zonën me rrezikshmëri të

ulet, ne vazhdojmë të kemi raste me Covid - 19 për çdo ditë, si dhe vdekje çoftë si pasojë e efekteve të Covid – 19, çoftë edhe me komplikime të tjera shëndetësore që pastaj me infektim të virusit ata përfundojnë me vdekje. Ne si shtabe kemi kërkuar nga të gjithë që të respektohen masat anti Covid – 19, që nga dita e sodit QKMF –ja në Rahovec ka filluar bërjen e testeve Rapid, ku i kanë në dispozicion rreth 3.500 doza dhe me këtë besoj se do të kemi mundësi të kemi një pasqyrë më objektive të gjendjes me virusin Covid -19 në Komunën tonë. Natyrisht se zgjedhjet e mbajtura me 14 shkurtë kanë prodhuar efektet në të gjithë Kosovën, qoftë për arsye të tubimit të madh të njerëzve gjatë fushatës parazgjedhore ashtu edhe gjatë fushatës zyrtare. Dhe ne tani pasojat e kësaj fushate veç i kemi evidente, por kjo nuk është vetëm në komunën tonë për në të gjithë Kosovën, natyrisht përgjegjësia bie në partitë politike në rashë të parë, por poashtu edhe imja si kryetar komuna dhe si zyrtar. Policia e Kosovës dhe inspektorati i Komunës janë përpjekur që të bëjnë punën e tyre në funksion të zbatimit të masave, poashtu kanë ndërmarrë edhe masa ndëshkimore sidomos policia dhe inspektorët e AVUKUT. Shpresoj se me ardhjen e vaksinës ne do të kemi më lehtë fitoren me Covid – 19 edhe pse ne nuk jemi kompetent që ta dimë se kur do të vije vaksina, por ne shpresojmë se kjo do të ndodhë sa më shpejtë. Ne si komunë jemi shpallur si komuna më e mirë që i ka respektuar masat anti Covid – 19 nëpër shkollat, dhe ky është një vlerësim inkurajues që ne të vazhdojmë edhe më tutje. Ministria e Arsimit nuk është duke e alukuar pjesën e dytë të mjeteve për të cilën është zotuar, prandaj ne kemi vështirësi në zbatimin e pjesë së dytë të kontratës për sa i takon materialeve mbrojtëse. Kjo ishte sa i përket anës sime për situatën e krijuar me Covid – 19, nëse ka dikush të shtoj diçka ose të pyes fjala është e juaja. Nëse nuk ka askush të shtoj diçka atëherë ne si konkluzion të pikës së parë të rendit të ditës mundemi të themi se:

Konkluzioni: Komuna duhet të vazhdojë që ta ketë vëmendjen e shtuar sa i përket situatës me Covid – 19, poashtu duhet të ketë aktivitete të vazhdueshme për parandalimin e përhapjes së mëtutjeshme të virusit Covid – 19, poashtu edhe veprimet e tjera të cilat lidhen me trajtimin ose menaxhimin e rasteve që i kemi ne si komunë. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Përkundër faktit që i kemi pasur zgjedhjet e jashtëzakonshme, poashtu edhe përkundër faktit që jemi me pandemi, sipas gjitha informatave dhe burimeve që i kemi, gjendja në Komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, me disa incidente të vogla për të cilat nuk duhet diskutuar. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunën tonë kanë kaluar të qeta dhe pa ndonjë incident. Sa i përket problemeve ndëretnike nuk kemi pasur, siç e dini pjesë e garës politike kanë qenë edhe komunitetet jo shumicë, por nuk ka pasur ndonjë rast i raportuar sa i përket problemeve ndëretnike. Kemi pasur reshje të shiut në këtë periudhë, ku ka pasur edhe përmbytje dhe janë dëmtuar prona të shumta, amvisëritë, tokat dhe bizneset, në disa pjesë ka kërcënuar edhe jetën e qytetarëve. Por këto situata nuk varen nga ne, ajo që është varur nga ne, ne jemi munduar që të ndërhyjmë si me zjarrfikës ashtu edhe me kompani të ndryshme me mjete si bagera që ti përballojmë me sa më pak pasoja situatën me vërshime. Sa për informacion komisioni për dëmtshpërblim ka vendosur që 28% të dëmtuarve në amvisëri të i kompensoj, që i bie rreth 154.000 € nga gjithsej sa kanë qenë 669.000 €, këto mjete janë tani në fazën e ekzekutimeve, presim që të kemi rezultate konkrete edhe në dëmet në bujqësi, dëmet në biznese dhe dëmet në infrastrukturë, se sa do të arrihet kjo ne jemi duke pritur sepse ne raportet i kemi përcjellë tek organet kompetente. Për më shumë fjalën ja kalojë komandantit të stacionit të policisë z. Fazli Morina, që të na raportoj për situatën e sigurisë në Komunën e Rahovecit.

Fazli Morina - Komandanti i policisë, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, por një falënderim të posaçëm desha të bëjë për FSK-në njësitit për reagim dhe shpëtim, si në emrin time personal poashtu edhe në emër të stacionit policor në Rahovec, për kërkimin të personit të zhdukur në lumin Drini i Bardhë. Ky njësitë është angazhuar deri në gjetjen e kufomës dhe për këtë edhe një herë ju them faleminderit. Sa i përket situatës sonë të sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë, pothuajse kryetari i tha të gjitha sa i përket tubimeve, fushatave dhe ditës së

zgjedhjeve, ku kanë kaluar pa asnjë akçes të vetmin, në përjashtim të gjobave për arsye të tubimeve me numër të madhe të njerëzve. Por situata e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë mbetet e qetë dhe stabile. Poashtu do të flas pak edhe për situatën e pandemisë Covid – 19 në komunën tonë. Gjatë periudhës raportuese të gjitha njësitë e stacionit policor në Rahovec kanë qenë të angazhuar në drejtimin e implementimit të Planit Operativ për gatishmëri dhe reagim për Corona Virus Covid – 19, së bashku me drejtorin regjionale të policisë në Gjakovë duke vepruar në përputhje me zhvillimet aktuale të situatës dhe vendimet e tjera. Poashtu patrullat tona kanë bërë asistimin e inspektorëve komunale duke bashkëvepruar konform kërkesave dhe nevojave në teren, për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid -19. Gjatë kësaj periudhe në komunën tonë janë shënuar 608 gjoba konform ligjit Nr. 07/L-006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid -19, prej tyre 577 gjoba janë për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 23 gjoba për tejkalimin e numrit të pjesëmarrësve në tubime publike (politike) dhe 8 gjoba për mos respektimin e orarit. Poashtu gjatë kësaj periudhe janë regjistruar gjithsej 69 raste, prej tyre 64 vepra penale dhe 5 incidente të ndryshme, nga këto që u ceken më parë mundemi të i vegojmë disa vepra më të rënda: vjedhje kemi pasur 4 raste, vjedhje të rënda 13 raste, mbajtje në pronësi të pa autorizuar të armeve 2 raste, dhe dhuna në familje 6 raste. Lidhur me rastet e cekura nga njësitet përkatëse në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe hetimeve rajonale në Gjakovë, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore.

Siguria në Trafik – Situata në komunikacion rrugor në qytetin e Rahovecit , konkretisht çështja parkimit të veturave në trotuare vazhdon të jetë dukuri shqetësuese për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun urban. Mungesa e parkingjeve publike, mungesa e trotuareve në disa pjesët e rrugëve të qytetit si Rr. “Gëzim Hamza” dhe Rr. “Ibrahim Rugova”, si rrugë më të frekuentuara nga nxënësit e dy shkollave të mesme dhe qytetarëve , duke pasur parasysh bllokimin e rrugës kryesore “Xhelal Hajda”, për shkak të punimeve të kanalit të madhe për rrjetin e kanalizimit. Pastaj dukuria e bllokimit të trotuareve vazhdon të jetë shqetësuese dhe paraqet rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në trafik e në veçanti për këmbësorët pjesë e të cilëve janë fëmijët, nxënësit, të meshuarit, personat me nevoja të veçanta. Policia e Kosovës në vazhdimësi do të ndërmerr masat e nevojshme të sigurisë për të mundësuar lëvizjen e lirë për të gjithë kategoritë e pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor. Lidhur me parandalimin e kundërvajtjeve në trafik nga patrullat tona policore, gjatë kësaj periudhe janë shënuar gjithsej 678 gjoba të trafikut duke u bazuar ligjit me Nr. 05/L-088, edhe pse ky numër nuk është i vogël, por përsëri nuk janë duke u vetëdijësuar qytetarët.

Qentë endacak - Nuk është ndonjë befasi, kjo dukuri është e përhapur çdo ku në Kosovë, poashtu edhe një zyrtar policor e kanë kafshuar qentë endacak. Dukuria e prezencës së qenve endacak në qytet dhe në lokacionet senzitive, në nivel vendi, është mjaft shqetësuese, e poashtu edhe në zonën tonë të përgjegjësisë kjo dukuri është prezentë. Gjatë periudhës raportuese kemi pranuar disa informata për prezencën e qeneve në qytetin e Rahovecit dhe në disa lokacione në fshatra. Rasti i fundit ka qenë lëndimi trupor i një personi, shkaktuar nga kafshimi i një qeni endacak, ka ndodhur në fshatin Zoqishtë, me çrrastë viktima ka pranuar tretmanin mjekësor në QKMF – Rahovec, ndërsa në konsultim me prokurorin rasti është mbyllur me shënim zyrtar.

Siguria në Shkolla – Policia e Kosovës në nivel qendror, në vazhdimësi është e përkushtuar lidhur me sigurinë e nxënësve, kuadrit arsimor dhe objekteve shkollore, ku gjatë periudhës raportuese, në muajin shkurtë 2021 është riaktivizuar plani operativ Siguria në Shkolla – 2021. Në kuadër të këtij plani janë ndërmarrë një mori aktiviteteve si: Mbajtja e katër takimeve me drejtoritë e shkollave, këshillin e prindërve dhe nxënësve të shkollave të mesme , me qëllim të evidentimit dhe parandalimit të incidenteve dhe dukurive negative në shkolla. Pastaj janë bërë vizita në shkolla, kontaktet me drejtorët dhe kuadrin arsimor, pika kontrolli afër shkollave të qytetit dhe në lokacionet e frekuentuara me nxënës si: Në rr. “Gëzim Hamza”, rrugën “Ibrahim Rugova”, te stacioni i autobusëve etj. poashtu edhe afër shkollave të mesme në Ratkoc dhe Krushe të Madhe, ku përveç njërive patrulluese policore,, janë angazhuar edhe zyrtar policor ,e

rroba civile. Gjatë periudhës raportuese në zonën tonë të përgjegjësisë, janë regjistruar dy incidente në shkollë, të ndodhura brenda një periudhe të shkurtër. Rasti i parë është cilësuar sulm i lehtë trupor, ndërsa rasti i dytë sulm, që të dyja rastet kanë ndihur në SHML- 12 Maji në fshatin Ratkoc. Në rastin e parë tre të dyshuar, dy prej tyre nxënës të kësaj shkolle dhe tjetri jo nxënës, kanë hyrë në një klasë dhe e kanë sulmuar një nxënës të kësaj shkolle, duke i shkaktuar lëndime trupore. Pas konsultimit me prokurorin e shtetit, dy të dyshuar janë ndaluar në mbajtje, i dyshuari i mitur është ndaluar për 24 orë ndërsa i dyshuari tjetër për 48 orë. Edhe në rastin e dytë ngjarja ka ndodhur e njëjtë si në rastin e parë, ku tre persona të dyshuar, dy prej tyre nxënës të shkollës dhe tjetri jo nxënës, kanë hyrë në korridor të shkollës dhe kanë sulmuar një nxënës të kësaj shkolle, rasti cili në konsultim me prokurorin është në procedurë të rregullt, por pa të arrestuar. Kjo ishte e gjitha sa i përket raportimit nga ana ime, nëse ka dikush ndonjë pyetje këtu jam për të ju përgjigjur.

Shaip Shala – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndalem tek dhuna familjare dhe siç e dëgjova komandantin e ceku se për këtë periudhë kanë qenë vetëm 6 raste, këto raste sigurisht denoncimet janë bërë nga gjinia femërore, por desha të pyes komandantin për gjithë vitin akademik, a ka pasur raste të denoncimit nga gjinia mashkullore ndaj gjinisë femërore për dhunë familjare. Këtë e them për faktin se kam informata jo zyrtare se në qytetin e Rahovecit ekzistojnë së paku 10- 15 meshkuj që gratë e tyre ushtrojnë dhunë ndaj tyre.

Fazli Morina – E thash që gjithsej janë 6 raste të dhunës në familje, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar mundemi të themi rastet janë përafërsisht të njëjta, ka shumë pak dallime. Kurse a ka raste të maltremit nga ana e gjinisë femërore ndaj gjinisë mashkullore, tani për tani nuk mundem të them, por nuk përjashtohet kjo mundësi sepse të gjithë jemi krijesa njerëzore dhe nëse ndodh diçka e tillë nuk duhet të habitemi.

Kryetari – Ajo që unë ju kisha lutur është që këto raste nëse ekzistojnë të denoncohen si në organet e rendit ashtu edhe në Qendrën për Punë Sociale sepse aty janë organet më të specializuara të cilat merën me këto raste, ekziston shtëpia e sigurt si për gra ashtu edhe për bura. Komandanti e përmendi edhe problemin me qentë endacak, ne si komunë e kemi nënshkruar edhe një kontratë për trajtimin e qeneve endacak, por ne nuk mundemi me i trajtu 30 mijë qen endacak, por ne i trajtojmë me kapacitetet tona buxhetore, për arsye se AVUKU nuk ka bërë asgjë, ajo që ka qenë si plan kombëtar për trajtimin e qeneve endacak nuk është zbatuar dhe ne kemi gjatë modelin që komuna të bëjë diçka për vete në mënyrë që të vijë deri tek zvogëlimi i kafshimit të qeneve endacak. Zyrtarit policor i uroj shëndet dhe shpresoj se sa më shpejtë të kthehet në vendin e punës, ne askujt nuk i dëshirojmë një gjë të tillë. Sa i përket ndriçimit publik mendoj se e ritë sigurinë në rrugët e Komunës së Rahovecit, këtë nuk e them unë por e thonë edhe ata që janë më kompetent, sepse ndriçimi publik jo vetëm që i ndriçon rrugët por rritë edhe sigurinë në lagje. Besoj se do të vërehet edhe zvogëlimi i kriminalitetit me rastin e ndriçimit të lagjeve, sepse do të zvogëlohen vjedhjet, thyerjet e makinave që janë bërë kohë pas kohe. Sa i përket mungesës së trotuareve, mundemi të themi se krijon pasiguri, ne kemi probleme me trotuare në rrugën “Gëzim Hamza – Piktori”, dhe në disa rrugë tjera të qytetit, kjo ndodh për arsye se nuk ka hapësirë publike, por në disa vende edhe ku ka trotuare ne i shohim qytetarët që ecin në mes të rrugës, mendoj që duhet të ketë më shumë vetëdijesim tek qytetarët. Një punishte që është hapur në rrugën “Xhelal Hajda – Toni”, pra një kanal për ujërat atmosferik, kjo ka qenë nevojë, kërkesë dhe interes, e kuptoj edhe vështirësinë e qytetarëve sepse e ka bërë edhe më të dendur qarkullimin tek rrugët “Ibrahim Rugëva” dhe “Gëzim Hamza”. Ka pasur disa zëra që na kanë sugjeruar që ta bëjmë disa rrugë një drejtimesh, për të bërë këtë duhet të vijë ndonjë propozim nga ekspertët sepse ne nuk e dimë a jemi duke bërë më mirë apo më keq, neve asnjë rekomandim nuk na ka ardhur nga grupi i eksperteve si nga policia apo nga njerëzit me përvojë në komunikacion. Por sidoqoftë punishtja është duke u ofruar ka fundi dhe shpresoj se do ta zgjidhë një herë e mirë problemin me ujërat nga reshjet e shiut. Poashtu ne si Komunë e kemi nënshkruar përsëri marrëveshjen për vitin 2021 me Bashkësinë Islame për mbulimin e

shpenzimeve të varrimit, poashtu e kemi propozuar edhe një propozim për kuvend dhe shpresoj se do të kalojë, propozimi është që të subvencionohen nënat lehonë me nga 200 € për çdo lindje. Për fund desha edhe unë të falënderoj ekipin e kërkim shpëtimit të FSK-së ose siç ndryshe quhen Togu i Ujërave, të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në gjetjen e trupit të pajetë të mësuesit Naim Gashi në ujërat e Drinit të Bardhë. Ne si komunë jemi përpjekur që simbolikisht të i ndajmë nga një mirënjohje të gjithë pjesëtarëve të ekipit të cilët kanë marrë pjesë, shpresojmë që do të jetë rasti i fundit dhe nuk do të kemi më raste të tilla. Kaq nga ana ime nëse nuk keni diçka të shtoni sa i përket kësaj pika do të kalojmë në pikën e radhës.

4. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve Urbane.

Kryetari – Kjo do të jetë me siguri një ballafaqim përveç komunikimit dhe bashkëpunimit që kemi me njerëzit e zgjedhur nëpër fshatra dhe lagjet urbane, sigurisht që do të diskutohet për planet e këtij viti, poashtu ne si komunë do ti dëgjojmë edhe shqetësimet dhe kërkesat e tyre për planifikimet e projekteve për vitin e ardhshëm. Ne shumë shpejtë do ta organizojmë takimin me kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, kjo do të bëhet në përputhje me masat që janë dalë nga qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Të ndryshme.

Fazli Morina – Do të kthehem edhe një herë tek siguria në trafik ku i kam një dy kërkesa, si breng kryesorë për ne dhe besoj se edhe për gjithë të therët është parkimi që bëhet tek qendra e qytetit, me gjithë respektin këtu i kemi edhe imamin e xhamisë në qendër dhe përfaqësuesit e teqeve. Por qendra sa i përket parkingjeve dhe shkaktimin të ngufatjes për një lëvizje të lirë të pjesëmarrësve të tjerë në trafik është një realitet që munden ta shohin të gjithë sidomos ditëve të premte, kur të gjitha ata që shkojnë për të falur xhumanë shkaktojnë një tollovi me makina dhe në atë kohë komunikacioni pothuajse është i bllokuar. Kësaj i paraprinë edhe dy lokale që shesin pemë dhe perime sepse këto dy lokale mallin e ekspozojnë në trotuar, pastaj një numër i madh i blerësve ndalojnë aty dhe kështu komunikacioni bëhet shumë i vështirë. Prandaj kërkoj nga gjithë ju që jeni prezent sot këtu që të ndikojmë dhe të përmirësojmë këtë gjendje, sepse ne shumë shpesh jemi duke i mbyllur sytë por me keqardhje e them që gjithmonë nuk mundemi.

Nysret Abazibra – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket shqetësimit që e ngriti komandanti i policisë, ne me këtë shqetësim pajtohemi plotësisht sepse është një problematik të cilën edhe ne jemi duke e përjetuar në vazhdimësi,, unë nuk kam çka të ju them komandant përveç asaj që zbatoni ligjin. Kjo është një situatë për të cilën edhe ne shumë herë jemi duke e apeluar që mos të parkojnë, ne i kemi dy objekte private të cilat përdoren për parkingje nga ana e qytetarëve, njëri është objekti i ri që është ndërtuar tani, qytetarët të cilët jetojnë aty afër i parkojnë makinat e tyre dhe ne shumë shpesh po kemi probleme me parking aty. Ne kemi menduar që të bëjmë një farë rezervimi të atyre parkingjeve sepse ajo është pronë a e jona, prandaj ne juve plotësisht ju mirëkuptojmë sepse ligji është mbi të gjithë. Poashtu edhe unë desha të përshëndes vazhdimin e marrëveshjes për mbulimin e shërbimeve të varrimit, poashtu desha të ju njoftoj se si kompletim i këtij shërbimi është përfundimi i punimeve në ndërtimin e morgut i cili përmban edhe vend për pastrimin e kufomave. Ky objekt i ka dy funksione njëri është pastrimi i kufomave dhe tjetri është ruajtja e kufomave për një afat të gjatë, pra me ditë të tëra sepse aty janë kushtet me të gjitha standardet, zoti na ruajt shpresoj se nuk do të kemi raste por deri në 7 kufoma është e paraparë. Unë bëjë apel që këtë objekt ta shfrytëzojmë sepse ene kemi ende probleme me mentalitet sepse shumë familje ende insistojnë që pastrimi i kufomave të bëhet nëpër shtëpi, ne si ta zgjidhim këtë problem nuk kemi fuqi ligjore, por ky shërbim që të kryhet nëpër familje më nuk ekziston përderisa i kemi kushtet në këtë objekt.

Sabahudin Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem sa i përket parkingjeve që e shtroj si shqetësim komandanti i policisë, edhe ne në Teqen Rufai e kemi një problem, aty është një parkim i dedikuar për vizitorët e Teqesë Rufai, problemi është se banorët që jetojnë aty e gjejnë në vend shumë të përshtatshëm për parkimin e makinave dhe i parkojnë me javë të tëra aty makinat e tyre. Pastaj problemi tjetër është se një kojshi e ka hapur një

kompani që i cili jep makina me qira dhe ato makina i parkon po në këtë vend sepse sipas tije ai nuk ka oborr në shtëpinë e vetë dhe nuk ka tjetër ku ti parkojë, prandaj edhe unë sikurse imami pajtohem e mate që e tha që ju vetëm zbatoni ligjin. Të nderuar sot është 22 marsi dita e Sulltan Nevruzit, prandaj në emër të Shehut të teqesë Rufai, i uroj të gjithë atyre që e festojnë këtë festë, mundeni të thoni se nuk është festë zyrtare, ashtu edhe është, por Bashkësia a Tarikateve të Kosovës e ka bërë një kërkesë në parlamentin e Republikës së Kosovës të jetë si festë zyrtare në kalendarin e festave të republikës së Kosovës dhe ne kemi shpresa se kjo së shpejti do të bëhet.

Kryetari – Pasi u hapën këto tema do të them edhe unë disa fjalë, secili nga ne poashtu edhe institucionet e kanë për detyrë që ta zbatojnë ligjin dhe asgjë as më pak dhe as më shumë nuk kërkohet. E kuptoj edhe shqetësimin e Imamit dhe nëse ka morg nuk është mirë që të mbahen trupat e pajetë nëpër familje sepse kanë ndryshuar shumë rrethanat edhe pse ne e dimë që kemi traditë që i vdekuri të qëndroj në shtëpi. Sa i përket parkingjeve ne do të kujdesemi që të kemi shenjëzim të parkingjeve edhe për arsye se edhe grandit për performancë komunal na kërkon që të kemi shenjëzime të parkingjeve nëpër prona publike. Ne poashtu e kemi edhe një rregullore komunale dhe për detyrë e kemi kur të ndërtohet edhe ndonjë objekt privat posaçërisht nëse është ndërtesë e lartë, njëri nga kriteret është edhe parkingu, poashtu edhe objektet publike si dhe objektet fetare duhet të kenë realisht lehtësira në qarkullim si hyrje dhe dalje. Por e vërteta është se në qytat ka parkingje të mjaftueshme por duhet që pakës të ecim në këmbë e jo të tentojmë me makinë të hymë në xhami, teqe ose nëpër lokale. Të nderuar a keni diçka të shtoni sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë, mirë u takofshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në orën: 16:35

Protesmbajtësi

Agim Hoti

Kryetar i Komunitetit

Smaji Latifi

